

## A3 \_ DRAFT KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Nr. i Referencës së Kontratës: <numër>

<Emri i plotë dhe adresa e autoritetit kontraktor>

(“Autoriteti kontraktor”),

nga njëra palë,

dhe

<Emri i plotë zyrtar i kontraktorit>

<Adresa e plotë zyrtare>

<Numri i NIPT-it>

<Përfaqësuesi i autorizuar>, (“kontraktori”)

nga pala tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

### KONTRATE

#### Neni 1: Objekti i Kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është “<pershkrimi>”. Kontraktori do të kryejë detyrat që i janë caktuar në përputhje me Termat e Referencës bashkëlidhur Kontratës.

#### Neni 2: Vlera e kontratës

- 2.1. Kjo kontratë është hartuar në Euro dhe është kontratë me çmim të bazuar në tarifa. Bazuar në tarifat maksimale, me një tarifë ditore prej <numër>. EUR/ditë, dhe duke parashikuar verifikimin e shpenzimeve, vlera maksimale e kontratës është EUR <numër>.

#### Neni 3: Kohëzgjatja e kontratës

- 3.1 Kohëzgjatja e kontratës është nga <data> deri më <data>, ose çdo periudhë tjetër që mund të bihet dakord më pas me shkrim ndërmjet palëve.

#### Neni 4: Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

- 4.1 Dokumentet e mëposhtme do të konsiderohen se përbëjnë pjesë të kësaj kontrate dhe do të lexohen e interpretohen si pjesë e saj, sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:

- i Marrëveshja e kontratës
- ii Kushtet e veçanta (Aneksi I);
- iii Kushtet e përgjithshme (Aneksi II);
- iv Termat e referencës (Aneksi III)
- v Oferta teknike – CV-ja e ekspertit (Aneksi IV)
- vi Oferta financiare (Aneksi V)
- vii Formularë dhe dokumente të tjera (Aneksi VI, nëse/kur është e zbatueshme)

- 4.2 Dokumentet e listuara më sipër përbëjnë kontratën. Ato do të konsiderohen se shpjegojnë njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë. Në rast paqartësie ose mospërputhjeje, ato do të kenë përparësi sipas rendit në të cilin paraqiten më sipër. Shtesat do të kenë rendin e përparësisë së dokumentit që ato ndryshojnë.

#### Neni 5: Gjuha e Kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është anglishtja dhe gjuha e të gjitha komunikimeve me shkrim ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktues dhe/ose menaxherit të projektit do të jetë anglisht ose shqip.

#### Neni 6: Dorëzimet, raportet e ndërmjetme dhe raporti përfundimtar

- 6.1 Kontraktori do të angazhohet pa rezervë në ofrimin e shërbimeve të treguara në Termat e Referencës dhe në ofertën teknike të Kontraktorit. Kontraktori do të zbatojë shërbimet dhe do të dorëzojë produktet brenda datave të përcaktuara dhe në përputhje me kushtet e kontratës.

- 6.2 Kontraktori do të paraqesë raporte progresi sipas përcaktimeve në Termat e Referencës.

#### Neni 7: Miratimi i raporteve dhe dokumenteve

- 7.1 Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga marrja, do ta njoftojë Kontraktorin për vendimin e tij lidhur me dokumentet ose raportet e marra prej tij, duke dhënë arsyet nëse i refuzon raportet ose dokumentet, ose kërkon ndryshime. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk jep komente mbi dokumentet ose raportet brenda afatit kohor, Kontraktori mund të kërkojë pranimin e tyre me shkrim. Dokumentet ose raportet do të konsiderohen të miratuara nga Autoriteti Kontraktues nëse ai nuk e informon shprehimisht Kontraktorin për ndonjë koment brenda 30 ditëve nga marrja e raportit.

#### Neni 8: Pagesa dhe interesi për pagesën me vonesë

- 8.1 Pagesat ndaj Kontraktorit do të kryhen sipas planit të mëposhtëm:

Muaji	Pershkrimi	Pagesat
<data>	Pagesë e ndërmjetme #1: <pershkrimi>	Rreth <X%> e vlerës së kontratës
<data>	Pagesa përfundimtare: <pershkrimi>	Rreth <X%> e vlerës së kontratës
	Totali	<Total contract value>

- 8.2 Pagesat mund të kryhen në EUR ose në ALL, të konvertuara me kursin e këmbimit sipas rregullave dhe procedurave të zbatueshme të projektit, në përputhje me nenin 3 të kushteve të përgjithshme, me transfertë bankare në llogarinë bankare të njoftuar nga Kontraktori tek Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 9: Komunikimet

- 9.1 Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i bërë në përputhje me këtë Kontratë do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se është bërë kur i dorëzohet personalisht një përfaqësuesi të autorizuar të Palës së cilës i drejtohet komunikimi, ose kur dërgohet me postë të regjistruar, faksimile ose email apo sistem tjetër elektronik te kjo Palë në adresën e përcaktuar më poshtë:

Nëse i drejtohet Autoritetit Kontraktues	Nëse i drejtohet Kontraktorit
<Emër Mbiemër:>	<Emër Mbiemër:>
<Adresë:>	<Adresë:>
<Adresë e emailit:>	<Adresë e emailit:>
<Numër telefoni:>	<Numër telefoni:>

- 9.2 Një sistem elektronik i dakordësuar ndërmjet tyre do të përdoret nga Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktori për të gjitha fazat e zbatimit, duke përfshirë, ndër të tjera, menaxhimin e Kontratës (ndryshimet dhe urdhrat administrativë), raportimin (duke përfshirë raportimin mbi rezultatet) dhe pagesat.

#### Neni 10: Vizibiliteti

- 10.1 Autoriteti Kontraktues dhe financimi i donatorit për angazhimin kërkojnë vizibilitet të përshtatshëm për kontributin e tyre. Kontraktori do ta pasqyrojë në mënyrë të duhur këtë mbështetje gjatë angazhimit dhe do të mbledhë prova të këtij vizibiliteti, si paraqitja e duhur e kësaj mbështetjeje në workshop-e, në mbulimin mediatik, njoftime zyrtare dhe njoftime për shtyp, raporte dhe publikime që i referohen shërbimeve. Mënyrat e detajuara se si do të respektohen kërkesat e vizibilitetit do të diskutohen gjatë takimit fillestar ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktorit fitues, i cili do të mbahet pas nënshkrimit të kontratës.

#### Neni 11: Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Kontrata ndërmjet YSB dhe kontraktorit ("Kontraktori") i nënshtrohet ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje ose dallim që lind nga kjo Kontratë ose në lidhje me të, i cili nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

#### Neni 12: Dispozita të tjera

- 12.1 Me nënshkrimin e kontratës, Kontraktori jep pëlqimin e tij Autoritetit Kontraktues për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale që lidhen me këtë procedurë, nëse/kur është e zbatueshme. Autoriteti Kontraktues deklaron se do t'i ruajë dhe përpunojë të dhënat personale të Kontraktorit në

mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Hartuar në anglisht në dy originalë, një original për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktorin.

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:

Titulli:

Nënshkrimi:

Data:

**Për Kontraktorin**

Emri:

Titulli:

Nënshkrimi:

Data:

**Anekset:**

Aneksi I - kushtet e veçanta;

Aneksi II - kushtet e përgjithshme;

Aneksi III - specifikimet teknike;

Aneksi IV - oferta teknike/CV e specialitetit;

Aneksi V - oferta financiare;

Aneksi VI - formularët dhe dokumentet e tjera.